

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, si gjykatë civile e shkallës së dytë, në kolegjin e përbërë nga gjykatësit Makifete Saliuka, kryetare e kolegjit dhe Mediha Jusufi e Nenad Llaziq, anëtarë, në çështjen kontestimore të paditësit I.G. nga Prishtina, të cilin e përfaqëson me autorizim Nuhi Uka, avokat në Prishtinë, kundër të paditurës Korporata Energjetike e Kosovës (KEK) sh.a. në Prishtinë, me përfaqësuesin e autorizuar Z.Sh., jur. i dipl., për kompensim dëmi për shkak të lëndimit në punë, duke vendosur sipas ankesave të ndërgjyqësve të ushtruara kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë C.nr. 234/2011, i datës 28.5.2015, në seancën e mbajtur me dt. 13.11.2017, mori këtë:

## AKTGJYKIM

I. VËRTETOHET Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë C.nr. 234/2011, i datës 28.5.2015, në paragrafin I, II, III dhe IV të tij (*me përjashtim të pjesës ku është vendosur për kamatën e pranuar mbi shumat e gjykuara në emër të dëmit jomaterial*).

II. NDRYSHOHET Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë C.nr. 234/2011, i datës 28.5.2015, në paragrafin I të dispozitivit të tij, në pjesën që i referohet kamatës së; e pranuar mbi shumat e gjykuara në emër të këtij dëmi, ashtu që paditësit I.G. nga Prishtina, mbi shumat e gjykuara në emër të dëmit jomaterial (*për dhimbje fizike - 4.000,00 €; për frikë - 3.000,00 €; për zvogëlimin e aktivitetit jetësor - 5.000,00 €; për shëmtim trupor - 4.000,00 €*), i pranohet kamatë vonesa ligjore sipas normës së kamatës të cilën e pranojnë bankat e Kosovës në mjetet e afatizuara mbi një vit, pa destinim të caktuar, nga data 4.2.2015 (*që është data e ekspertizës mjekësore*), e deri në pagesën definitive, të cilën detyrohet t'ia paguaj e paditura Korporata Energjetike e Kosovës (KEK) sh.a. në Prishtinë, bashkë me shumën e tërësishme prej 17.770,00 €, për të gjitha format e dëmit, në afatin brenda 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, e nën kanosjen e përmbarimit me dhunë.

## Arsyetim

Gjykata e shkallës së parë, me aktgjykimin e goditur, paragrafi I dhe IV të dispozitivit të tij, e ka MIRATUAR PJESËRISHT SI TË BAZUAR kërkesëpadinë e paditësit dhe e ka DETYRUAR të paditurën, që paditësit, për lëndimet e pësura në vendin e punës, t'ia kompensoj dëmin me kamatë ligjore nga dita e lëndimit datë 23.9.2010, e deri në pagesën definitive, në shumat e specifikuar si më poshtë:

- në emër të dëmit jo material: për dhimbje fizike - 4.000,00 €; për frikë - 3.000,00 €; për zvogëlimin e aktivitetit jetësor - 5.000,00 €; për shëmtim trupor - 4.000,00 €;

- në emër të dëmit material: për ushqim të përforcuar - 750,00 € dhe për ndihmë dhe përkujdesje të personit të tretë - 1.020,00 €,

- duke ia pranuar edhe shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 959,00 €, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi.

Ndërkaq, me paragrafin II dhe III, REFUZOHET kërkesëpadia e paditësit për kompensimin e dëmit jo material dhe material mbi shumat e gjykuara dhe atë: për dhimbje fizike - 4.000,00 €; për frikë - 4.000,00 €; për zvogëlimin e aktivitetit jetësor - 15.000,00 €; për shëmtim trupor - 6.000,00 €; për ushqim të përforcuar - 750,00 € dhe për ndihmë dhe përkujdesje të personit të tretë - 2.480,00 €, si dhe kërkesëpadia e tij për kompensimin e dëmit në emër të zvogëlimit të aktivitetit punues dhe në emër të rehabilitimit fizioterapeutik.

Kundër këtij aktgjykimi, në afat ligjor ka ushtruar ankesë paditësi, përmes të autorizuarit të tij, për shkak të shkeljeve qenësore të dispozitave të procedurës kontestimore, aludohet në shkelje nga neni 182.2 pika n) e LPK-së, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, nga fakti se aksidenti i tij në punë nuk ka ndodhë me fajin e tij, dhe se shumat e gjykuara janë tepër të vogla dhe nuk janë në përputhshmëri me praktikën gjyqësore e as me lëndimin e paditësit i cili është i natyrës tepër të rëndë, me propozim që aktgjykimi i goditur të ndryshohet, me miratimin e kërkesëpadisë së paditësit në shumat e kërkuara nga ai, ose i njëjti të priset dhe lënda ti kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim.

Kundër këtij aktgjykimi, në afat ligjor ka ushtruar ankesë edhe e paditura, për shkak të shkeljeve qenësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182.2 pika n) e LPK-së, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, nga fakti se lëndimi i paditësit nuk ka ndodhur për fajin dhe përgjegjësinë e të paditurës, por pikërisht me fajin dhe përgjegjësinë e vet paditësit, i cili nuk i ka respektuar obligimet që dalin nga neni 3.1, 3.2, 3.4, 3.5 dhe 3.8 i Ligjit nr. 2003/19 për Siguri në Punë, Mbrojtje të Shëndetit të të Punësuarëve dhe Ambientit në Punë, me propozim që aktgjykimi i goditur të ndryshohet dhe kërkesëpadia e tij të refuzohet, ose i njëjti të priset dhe lënda ti kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim.

Gjykata e Apelit, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore të ndërgjyqësve, aktgjykimit të goditur dhe shkresave të lëndës, në pajtim me nenin 194 të LPK-së, gjeti se:

**Ankesa e paditësit është e pa bazuar.**

**Ankesa e të paditurës është pjesërisht e bazuar.**

Nga shkresat e lëndës vërehet se, paditësi, i lindur në vitin 1979, gjatë orarit të tij të punës, si punëtor i të paditurës, i sistemuar në punë dhe detyra të punës agjystator i ndërrimit "C"- Sektori i prodhimit – Departamenti i Serviseve, ditën kritike me datë 23.9.2010, rreth orës 6,<sup>40</sup> minuta, gjatë kryerjes së rregullt të detyrave të punës, është angazhuar në shuarjen e zjarrit në rulën amortizuese të gomës në Stacionin kthyes të shiritit transportues pozicioni 5.13, me ç' rast është aksidentuar, duke pësuar lëndime në kokë, trup dhe gjymtyrë, për çka i është dashur të trajtohet brenda dhe jashtë shtetit të Kosovës përkatësisht në Gjermani, ku ende vazhdon trajtimi i tij.

Lidhur me bazën juridike të kërkesëpadisë së paditësit, gjykata e shkallës së parë është bazuar në Mendimin e ekspertit për mbrojtjen në punë Doc.Dr.Ing. H.N., ekspert i sigurisë në punë, i datës 4.11.2014, i cili ka konstatuar se punëdhënësi, këtu e paditura, ka përgjegjësi sekondare për aksidentimin e paditësit për shkak se nuk ka siguruar informim të të punësuarit, këtu paditësit, përpara fillimit të punës, për rreziqet ndaj të cilëve ai mund të ekspozohet, në kuptim të nenit 13 paragrafi 1.3 i Ligjit nr. 04/L-161 për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë, ndërsa paditësi ka përgjegjësinë primare sepse nuk është kujdesur për sigurinë dhe shëndetin e vet në kuptim të nenit 53 dhe 17 pika 2 e Rregullores së KEK-ut për Siguri në Punë... dhe nenit 21 pika l e Ligjit nr. 04/L-161 për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë.

Ndërkaq, lidhur me natyrën e lëndimit të cilin e ka pësuar paditësi, gjykata e shkallës së parë vendimin e vet e ka bazuar në mendimin e ekspertëve mjekësorë Dr. Xh.S., ortoped-traumatolog

dhe Dr. A.K., neurokirurg, të cilët lëndimin e paditësit e kualifikojnë si lëndim të rëndë trupor dhe me pasoja të përhershme, që konsiston në:

*- Ndrydhje të regjionit të mushkërive në të dy anët; Thyerje e parakrahut të djathtë; Djegie në regjionin e qafës, nuhal, regjionin e shpatullës, deltoid djathtas pas djegies... Të njëjtit kanë konstatuar intensitetin dhe kohëzgjatjen e dhimbjes së përjetuar fizike të paditësit si pasojë e lëndimit të pësuar, zvogëlimin e aktivitetit të përgjithshëm jetësor në shkallën prej 25 %, zvogëlimin e aktivitetit punues në shkallën prej 30 %, shëmtimin trupor të paditësit në shkallë të mesme, nevojën e paditësit për përkujdesje nga personat e tretë në kohëzgjatje prej 12 muajsh, nevojën për ushqim të përforcuar në kohëzgjatje prej 12 muajsh dhe nevojën për rehabilitim fizioterapeutik klimatik në kohëzgjatje prej 4 vitesh, dy herë në vit nga 14 ditë për cikatrikset pas djegieve në regjionin e qafës dhe të shpinës.*

*Ndërsa ekspertja mjekësore Dr. N.M., psikiatër, ka vlerësuar frikën e përjetuar të paditësit, intensitetin dhe kohëzgjatjen e saj.*

Gjykata e shkallës së parë, pas vërtetimit të gjendjes faktike duke u bazuar në deklaratat e ndërgjyqësve dhe provat shkresore që gjenden në këtë lëndë, ku përfshihen edhe konstatimet e ekspertit për mbrojtje në punë për rrethanat e ndodhjes së aksidentit në punë ku është lënduar paditësi, dhe konstatimet e ekspertëve mjekësor lidhur me natyrën e lëndimeve të paditësit dhe pasojat e lëndimit, moshën (30 vjeç në kohën e aksidentimit) dhe nevojat e tij, si dhe frikën e përjetuar, me zbatimin e nenit 173, 174, 186 dhe 277 të Ligjit për Marrëdhënie Detyrimore, lidhur me nenin 2 paragrafi 2.10 të Ligjit nr. 2003/19 për Sigurinë në Punë, Mbrojtje të Shëndetit të të Punësuarve dhe Ambientit në Punë (i shpallur në Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2003/33, në fuqi në kohën e aksidentimit të paditësit), e ka miratuar pjesërisht si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit, duke e detyruar të paditurën që në emër të shpërblimit të dëmit material dhe jo material t'ia paguaj shumat e pranuar si në dispozitivin e aktgjykimit të goditur, me kamatë vonesë ligjore nga dita e lëndimit e deri në pagesën definitive, duke e llogaritur shkallën e përgjegjësise për ndodhjen e këtij aksidenti 50% me 50% - për të dy ndërgjyqësit, njëri punëdhënës e tjetri punëmarrës, duke e refuzuar kërkesëpadinë e paditësit përtej shumave të gjykuara, sikurse edhe kërkesëpadinë e tij për kompensimin e dëmit në emër të zvogëlimin të aktivitetit punues dhe në emër të rehabilitimit fizioterapeutik.

Gjykata e Apelit, duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes, vlerëson se nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të ndërgjyqësve se aktgjykimi i goditur është marrë me shkelje qenësore të dispozitave të LPK-së nga nenin 182.2 pika n) e LPK-së, dhe si pasojë e vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike gjë që, sipas tyre, ka rezultuar edhe me zbatimin e gabuar të së drejtës materiale.

Me nenin 200 të LMD-së janë parashikuar llojet apo format e shpërblimit të dëmit jo material dhe material dhe atë për dhimbje fizike trupore, për dhimbje shpirtërore, për zvogëlim të aftësisë së përgjithshme jetësore për frikën e pësuar etj.

Gjykata e shkallës së parë, në rastin konkret, pas vërtetimit të bazës juridike të kërkesëpadisë së paditësit, dhe pas vlerësimit të drejtë dhe të besueshëm, se përgjegjësia për ndodhjen e këtij aksidenti në punë bie mbi dy ndërgjyqësit në shkallën 50 me 50%, ka vendosur drejtë kur e ka miratuar të njëjtën në shumat e gjykuara si në dispozitiv të aktgjykimit të goditur, të zvogëluara sipas përgjegjësise së ndarë, (në emër të dëmit jo material: për dhimbje fizike - 4.000,00 €; për frikë - 3.000,00 €; për zvogëlimin e aktivitetit jetësor - 5.000,00 €; për shëmtim trupor - 4.000,00 € dhe në emër të dëmit material: për ushqim të përforcuar - 750,00 € dhe për ndihmë dhe përkujdesje të personit të tretë - 1.020,00 €), duke vlerësuar se këto shuma paraqesin kompensim real për format e dëmit që paditësi ka pësuar, dhe se me këtë kompensim do të zvogëlohen sado pak dhimbjet shpirtërore të tij për lëndimin e pësuar dhe pasojat e këtij lëndimi, i natyrës së rëndë, të cilit i është zvogëluar aktiviteti i përgjithshëm jetësor për 25 %, ndërsa aftësia për punë të rënda për 30%.

Edhe vendimi për kompensimin për dëmin material (*për ushqim të përforcuar dhe për ndihmë dhe përkujdesje të personit të tretë*), i marrë nga gjykata e shkallës së parë, sipas vlerësimit të gjykatës së shkallës së dytë, është në shumta korrekte të cilat edhe përkojnë me standardin mesatar të kostos së jetës në Kosovë, sikurse edhe vendimi për kërkesën aksesore që ka të bëjë me shpenzimet e procedurës i cili është i arsyetuar dhe i bazuar në dispozitën e nenit 452.1 të LPK dhe Tarifën për shpenzimet e avokatëve, e zbatueshme në Kosovë.

Nga ana tjetër, gjykata e shkallës së parë ka vendosur drejtë kur e ka refuzuar kërkesëpadinë e paditësit mbi shumat e gjykuara si në dispozitiv të aktgjykimit të goditur, sikurse edhe kur e ka refuzuar kërkesë padinë e paditësit për kompensimin e dëmit në emër të rehabilitimit fizioterapeutik – në mungesë të provave materiale për këtë formë të dëmit, prandaj aktgjykimi i goditur, si në pjesën miratuese ashtu edhe në pjesën refuzuese të tij, që ka të bëjë me kërkesat kryesore të paditësit – vërtetohet.

Gjykata e Apelit me rastin e vlerësimit të ankesës së të paditurës, pati parasysh edhe pretendimin e saj ankimor të saj se deri te lëndimi i paditësit ka ardhur ekskluzivisht me fajin e tij e jo me fajin e të paditurës, e cila në këtë rast e sipas saj, nuk ka kurrfarë përgjegjësie as objektive e as subjektive për lëndimin dhe kompensimin e paditësit, të cilin e vlerëson si të paqëndrueshëm dhe të pa argumentuar, për faktin se nuk mund të konsiderohet në asnjë mënyrë se vetëm paditësi i ka kontribuar lëndimit të vet, i cili është munduar ta shuaj zjarrin te e paditura, gjë që duhet vlerësuar, ashtu siç i është kërkuar dhe urdhëruar nga mbikëqyrësit e tij, e që kjo punë nuk mund të kualifikohet si punë plotësisht e parrezikshme - për ta përjashtuar paditurën nga çfarëdo përgjegjësie. Nga ana tjetër paditësi, si punëmarrës, nuk është lënduar me qëllim që ta dëmtoj veten, por që ka dështuar ti shmanget aksidentit-lëndimit.

Në këtë rast, kemi të bëjmë me përgjegjësi objektive të të paditurës në kuptim të nenit 173 të Ligjit për Marrëdhëniet Detyrimore, dhe se sipas nenit 177 të LMD, për tu liruar nga përgjegjësia për kompenzim dëmi ndaj paditësit, mbi të paditurën bie barra e të provuarit se paditësi është lënduar pa fajin dhe përgjegjësinë e saj dhe për arsytet që janë jashtë saj, gjë që e paditura nuk e ka provuar me asgjë. Përkundrazi, eksperti për mbrojtje në punë ka konstatuar se deri të aksidenti aktual përkatësisht fatkeqësia në punë në të cilën ka pësuar lëndime të rënda trupore paditësi - ka ardhur edhe me kontributin e të paditurës, prandaj edhe barra e përgjegjësisë për kompensimin e dëmit bie mbi te në proporcion me përqindjen e kontributit të ndërgjyqësve në ndodhjen e kësaj fatkeqësie në punë.

Si rezultat e duke pasur parasysh faktet e vërtetuara se paditësi është lënduar në punë, i angazhuar nga vet e paditura për shuarjen e zjarrit, edhe kjo gjykatë, si gjykatë e shkallës së dytë, përfundon se në kuptim të nenit 173, 174 dhe nenit 154 të LMD-së, e paditura është e obliguar që t'ia kompensojë dëmin e shkaktuar paditësit, për aq sa është vlerësuar nga gjykata e shkallës së parë kontributi-përgjegjësia e tij në raport me të paditurën (50% me 50%).

Aktgjykimi i goditur është i drejtë edhe në pjesën ku është refuzuar kërkesëpadia e paditësit për kompensimin e dëmit në emër të zvogëlimit të aktivitetit të tij punues në shkallën prej 30% për punë të rënda fizike, sipas vlerësimit të ekspertëve mjekësor, e që në këto situata punëdhënësi, ka për obligim që në kuptim në kuptim të nenit 47 të Ligjit të Punës, me të cilën parashihet mbrojtja e personave me aftësi të kufizuara, punëmarrësin e aksidentuar në punë, ta caktoj në tjera punë, e nëse eventualisht ka ndodhur ose do të ndodhë në të ardhmen që paditësi të sistemohet në punë tjera më të lehta te paditura por që paguhet më pak se punët e tij në të cilat ka qenë i sistemuar para aksidentimit, atëherë paditësi ka të drejtë, që me padi tjetër të veçantë, të kërkojë diferencën e pagave të paguara më pak.

Në tërë këtë situatë, përjashtim bënë vendimi i shkallës së parë vetëm në pjesën ku është vendosur për kërkesën aksesore të paditësit që ka të bëjë me kamatën, e cila sa i përket dëmit jomaterial nuk mund të pranohet nga dita e shkaktimit të dëmit, dhe nuk përkon me praktikën gjyqësore të krijuar nga Gjykata Supreme e Kosovës, prandaj, në kuptim të nenit 201 par. 1 pika d) e LPK-së, prandaj aktgjykimi i goditur në këtë pjesë ndryshohet, ashtu që paditësit, mbi shumat e gjykuara në emër të dëmit jomaterial, i pranohet kamatë vonesa ligjore sipas normës së kamatës të cilën e pranojnë bankat e Kosovës në mjetet e afatizuara mbi një vit, pa destinim të caktuar, nga data 4.2.2015 - që është data e ekspertizës mjekësore kur është vlerësuar ky dëm, dhe është krijuar mundësia që i njëjti të shprehet në para, e deri në pagesën definitive, ndërsa për dëmin material kamata mbetet e njëjtë ashtu siç ka vendosur gjykata e shkallës së parë, sipas kërkesës së paditësit, gjë që është në pajtim me nenin 186 të lidhur me nenin 277 të LMD-së.

Vendimi i goditur nuk përmban as shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par. 2 pika n) e LPK\_së, në të cilën thirren ndërgjyqësit e as shkelje tjera nga neni 182.2 pika b), g), j), k) dhe m) të LPK-së, për të cilat kjo gjykatë, si gjykatë e shkallës së dytë, kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së.

Për arsyet e paraqitura si më lart, Gjykata e Apelit në pajtim me dispozitën e nenit 201 par. 1 pika d) lidhur me nenin 195 par. 1 pika d) dhe e) e LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS**  
**AC.nr. 4203/2015, datë 13.II.2017**

**KRYETARJA E KOLEGJIT-GJYKATËSJA,**  
*Makifete Saliuka*